



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Administratës Publike*  
*Ministarstvo Javne Uprave-Ministry of Public Administration*

**K O N K U R S**

**Ministria e Administratës Publike** në bazë të Nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës shpall konkurs për:

**Titulli i vendit të punës:** Sekretar i Përgjithshëm në:

- Ministrin e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (1),
- Ministrin e Financave (1),
- Ministrin e Punëve të Brendshme (1),
- Ministrin e Zhvillimit Ekonomik (1),
- Ministrin e Drejtësisë (1),
- Ministrin e Kulturës Rinisë dhe Sporteve (1).

**Paga mujore:** 693.00 €

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Siguron këshilla të politikave për ministrin; siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të ministrisë të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive, siguron që masat zbatuese të ministrisë të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave, menaxhon nëpunësit civil dhe punonjësit tjerë të ministrisë, menaxhon financat dhe burimet tjera të ministrisë, menaxhon rrjedhën e informacionit në ministri, koordinon raportet e ministrisë me organet e tjera vartëse administrative, bashkëpunon me sekretaret e ministrive tjera në bazë të rregullt etj.

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:**

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësitë fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Procedurat e konkurrimit:**

- Procedura e konkurrimit për Sekretar të përgjithshëm është e hapur dhe zgjidhet nga nëpunësit civilë të klasifikuar në pozita të larta drejtuese dhe pozita drejtuese ose në pozita të barasvlershme në institucionet e administratës publike ose kompanitë publike dhe private të cilët janë kandidatë për pozitën përkatëse.

**Shkollimi i kërkuar:**

- Diplomë universitare (minimum 4 vjeçare pas shkollës së mesme) apo të avancuar në fushat që ndërlidhen me punën e ministrisë.

**Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:**

- Duhet të kenë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negocimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri bazike në programet e kompjuterit, së paku 5 vjet përvojë profesionale dhe menaxhuese, e preferueshme në nivele të larta dhe në fusha që ndërlidhen me punën e ministrisë, njohja e gjuhëve të huaja është e dëshiruar.

**Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:**

- Përzgjedhja e Sekretarëve të Përgjithshëm bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

**Kohëzgjatja e emërimit:**

- Mandati për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është 3 vjeçar.

**Data e mbylljes së konkursit:**

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

**Paraqitja e kërkesave:**

- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Ministrinë e Administratës Publike, Zyra e Personelit, dhoma nr 320, kati III , ndërtesa e Pallatit te shtypit, Prishtinë ose nëpërmjet adresës elektronike në linkun: <http://map.ks-gov.net>. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës.

*“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.*

*“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.
- Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni znj. Sala Shala në tel: 038-20030620, prej orës 8:00 - 16:00.